

Shtojca 14

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data 01.02.2021]

Për: *[Eco Riciklim, Rr.3 Deshmoret Yzberisht, Tirane]*

Procedura e prokurimit: E Hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-81894-12-11-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Evadim i mbeturinave të rrezikshme spitalore, për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë"-Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar (24 muaj) ”**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Eco Riciklim shpk**

L61814009B

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 21 112 638 (njëzetë e një milion e njëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH

(me numra dhe fjalë)

2. **MEDI TEL shpk**

J71519004W

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 12 133 700 (dymbëdhjetë milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind)lekë pa TVSH

(me numra dhe fjalë)

3. **Pura-Medical shpk**

L71515507M

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera Nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike

(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

2. **MEDI TEL**

J71519004W

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

3. **Pura-Medical shpk**

L71515507M

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Pura-Medical skualifikohet nga kjo procedurë prokurimi për mungesë dokumentacioni, pasi nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike dhe asnjë dokument në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST nga njësia e prokurimit.

- Meditel shpk skualifikohet përkatësisht për arësyet e mëposhtme:

1. Në pikën 2 të **Kapacitetit ligjor/profesional** të operatorëve ekonomikë ku njësia e prokurimit ka vendosur si kriter: *“Operatori ekonomik duhet të disponoje Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02; 18 01 08 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.”* Komisioni i vlerësimit të ofertave ka verifikuar se në Lejen e tipit A të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik MEDITEL përkatësisht me nr. PN-9903-03-2020 me Kod III.1.C, *Leje e Mjedisit e tipit A. Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. Incenerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incenerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1.a.* si dhe në Licencën përkatëse me nr LN-0357-03-2020 me Kod III.2.B *Grumbullim, depozitim, transportim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme me metodën e incenerimit,* nuk **përfshihen mbetjet me kodin 18 01 08 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.** Gjithashtu, në dokumentat e ngarkuara në SPE nga Operatori është vënë re se për mbetjet me kod **18 01 08 Mbetjet citostatike/citotoksike** është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me POLYECO ALBANIA SHPK , e cila **nuk merret parasys**h pasi **Operatori Meditel nuk paraqitet si Bashkim Operatorësh** në pjesëmarrjen e tij në këtë procedurë tenderimi për ofrimin e shërbimit të kërkuar, aq më tepër në një verifikim të bërë bazuar në VKM nr 914 datë 29.12.2014 I ndryshuar Neni 66 Shqyrtimi dhe vlerësimi I ofertave, Operatori ekonomik POLYECO ALBANIA SHPK me NIPT K92403020S E verifikuar ne faqen zyrtare te QKB, rezulton (Licencat aktive) se nuk është fare i pajisur me leje Tipit A me Kod III.1.C. por vetëm me Leje të Tipit B.
2. Në pikën 2 të Kapacitetit teknik ku njësia e prokurimit ka vendosur si kriter: *“Operatori duhet te kete ne pronesi /qira, minimalisht 2(dy) mjete dhe per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:*
 - *Për automjetin në pronësi: Aktin e pronësisë së mjetit, leje qarkullimi, akt - kolaudimi dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt -Miratimet Higjenosanitare, si dhe foto te mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese sipas sipas percaktimeve te bera ne Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore.*
 - *Për automjetet që nuk janë në pronësi: Kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi, si dhe leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me fotot ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese sipas sipas percaktimeve te bera ne Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore dhe Akt – Miratimet Higjenosanitare; gjatë verifikimit në sistemin e prokurimit publik për dokumentat e*

ngarkuara elektronikisht nga e operaorit MEDITEL ka verifikuar se janë dorëzuar dokumentat si më poshtë:

1-Për mjetin AA712 RY është dorëzuar:

Leje qarkullimi

SGS e vlefshme deri me 19.12.2021

Policë për sigurimin e detyrueshëm e vlefshme deri më 18/12/2021

Akt-miratimi higjeno-sanitar nr 48 datë 14.01.2019

Foto të mjetit

2-Si dhe për mjetin AA 056GH është dorëzuar:

Leje qarkullimi

Policë për sigurimin e detyrueshëm e vlefshme deri më 08/04/2021

SGS e vlefshme deri me 14.04.2021

Certifikate e pronësisë së mjetit

Akt-miratimi higjeno-sanitar nr 429 datë 28.04.2015

Foto të mjetit

Është konstatuar se për mjetin AA 712 RY nuk është dorëzuar **Akti i pronësisë së mjetit** ose në rastin se ky mjet nuk është në pronësi të kësaj firme nuk është dorëzuar **asnjë kontratë qiraje e shoqëruar kjo me aktin e pronësisë së qiradhënësit.**

3. Në pikën 6 të Kapacitetit teknik ku njësia e prokurimit ka vendosur si kriter: *“Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera impiantet per trajtimin me sterilizim dhe asgjesimin me incenerim të seciles kategori te prokuruar nga A.K te mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798 date 29.09.2010 per miratimin e rregullores “Per administrimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja). Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- Dokumentacionin per vertetimin e pronesise ose te marrjes me qera te pajisjes (ku afati i marrjes me qera te jete minimalisht sa afati i ekzekutimit te ketij objekti prokurimi);*
- Impiantet per trajtimin me sterilizim dhe asgjesimin me incenerim, duhet të jenë të pajisur me Leje Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B ose të jenë te pasqyruar në Lejet Mjedisore të paraqitura në përmbushje të kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 më sipër;*
- Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i prodhuesit te secilit impiant dhe makinerisë;*
- Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë”*

pas verifikimit të dokumentave të ngarkuara në SPE:

Së pari, për inceneratorin, operatori MEDITEL ka ngarkuar: faturën e transaksionit bankar për blerjen e tij, lejen e mjedisit, Kartën teknologjike të inceneratorit, si dhe Certifikatë ISO 9001:2015 të Elastec Inc, por nuk ka dorëzuar **Deklaratë Konformiteti**. Së dyti, për impiantin për trajtimin me sterilizim të kërkuar (autoklavën) ka dorëzuar: faturën e zhdoganimit, lejen mjedisore, dokumenta teknike të makinerisë, si dhe ISO dhe Deklaratën e Konformitetit. **Gjatë verifikimeve është konstatuar se ISO 9001:2008 e ka kaluar afatin e vlefshmërisë pasi certifikimi i fundit ka qensë i vlefshëm deri më 20.07.2020; si dhe deklarata e konformitetit e vlefshme deri më 31.05.2020 por në një vlerësim në distancë më 19.05.2020 afati i**

vlefshmërisë së deklaratës është zgjatur deri me 30.11.2020 që rezulton e pavlefshme në momentin e zhvillimit të kësaj procedure prokurimi.

4. Në pikën 7 të Kapacitetit teknik ku njësia e prokurimit ka vendosur si kriter: “*Operatori duhet te furnizojë me kontenitore sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III. Per te provuar plotesimin e ketij kriteri, operatori duhet te paraqese:*

- *Fatura blerje ose zhdoganimi*
- *Certifikaten e aprovimit te tipit te ambalazhit per secilin lloj kontenitori*

Kontenitorët duhet te jene te permasave si vijon:

- *Kontenitor plastike njëpërdorimësh për të mprehtat 18 01 01: në 3 (tre) përmasa që fillon nga 3 L deri 12 L*
- *Kontenitor plastike të ripërdorshëm me qese plastmasi njëpërdorimëshe, për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, në 3 (tre) përmasa që fillojnë nga 30 L deri në 60 L, shoqëruar me mekanizëm hapje me pedale për cdo përmasë, sipas Udhezuesit Kombëtar të Administrimit të Sigurte të Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.*
- *Kontenitor kartoni njëpërdorimësh me përmasë rreth 60 L per mbetje te buta 18 01 04*
- *Kontenitor te posacem njepërdorimesh te kuq per mbetjet citostatike 18 01 08*

Operatori ofertues duhet te paraqese ne ambientet e AK, ne daten dhe oren e hapjes se tenderit, nga nje moster te artikujve me sipër.

Mostrat e dorëzuara duhet te jene te shoqeruara me listen e inventarizimit. Nese ka mungesa mostrash per artikuj te vecante ose nese mostra/t nuk eshte/jane ne perputhje me specifikimet teknike, atehere oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te skualifikohet.”

Pas janë verifikuar dokumentat e ngarkuara prej operatorit MEDITEL në SPE në asnjë rast nuk janë paraqitur Fatura Blerje për kontenitorët apo zhdoganimi. Gjithashtu, në mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të tenderit operatori në fjalë ka dorëzuar, për pikën e parë “*Kontenitor plastike njëpërdorimësh për të mprehtat 18 01 01: në 3 (tre) përmasa që fillon nga 3 L deri 12 L*”- **Kontenitor plastike njëpërdorimësh për të mprehtat me kapacitet 6L, 7L, 12L. (në përputhje me specifikimet Teknike)**

Për pikën e dytë “*Kontenitor plastike të ripërdorshëm me qese plastmasi njëpërdorimëshe, për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, në 3 (tre) përmasa që fillojnë nga 30 L deri në 60 L, shoqëruar me mekanizëm hapje me pedale për cdo përmasë, sipas Udhezuesit Kombëtar të Administrimit të Sigurte të Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.*” **operatori Meditel ka dorëzuar kontenitor plastike të ripërdorshëm me qese plastmasi njëpërdorimëshe për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, në 3 (tre) përmasa 30L, 50L dhe 60L shoqëruar me mekanizëm hapje me pedale.(në përputhje me Specifikimet teknike)**

Për pikën e tretë “*Kontenitor kartoni njëpërdorimësh me përmasë rreth 60 L per mbetje te buta 18 01 04*” **operatori Meditel ka dorëzuar kontenitor kartoni me kapacitet 40L dhe 60L. (në përputhje me Specifikimet teknike)**

Si dhe për pikën e fundit të kërkuar “*Kontenitor te posacem njeperdorimesh te kuq per mbetjet citostatike 18 01 08* “ **operatori Meditel ka dorëzuar kontenitor 40L të kuq me kapak të verdhë, pa qesen përkatëse si dhe pa etiketimet përkatëse, i cili nuk është në përputhje me specifikimet teknike dhe sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.**

Gjatë verifikimit të bërë në SPE, është vënë re se edhe certifikatat e aprovimit janë në mospërputhje me mostrat e dorëzuara. Për mostrat me kapacitet 60 L nuk ka dorëzuar asnjë certifikatë aprovimi, si dhe për kontenierët e kartonit nuk janë dorëzuar certifikata aprovimi po vetëm ISO të kompanisë prodhuese.

5. Në pikën 8 të Kapacitetit teknik ku njësia e prokurimit ka vendosur si kriter: “*Per te garantuar larjen dhe dezinfektimin e kontenitoreve plastik te riperdorshem te mbetjeve spitalore , operatori duhet te disponoje makineri larese dhe dezinfektuese. Per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri operatoret duhet te paraqesin :*

- *Skeden teknike dhe deklaraten e konformitetit CE per makinerine larese/dezinfektuese*
- *Fature blerje ose zhdoganimi.*
- *Makineria larese duhet te jenë e pajisur me Leje Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B ose të jenë te pasqyruar në Lejet Mjedisore të paraqitura në përmbushje të kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 më sipër.”Gjatë verifikimit të bërë në dokumentat e ngarkuara prej operatorit MEDITEL në SPE për sa i përket këtij kriteri të përcaktuar nga njësia e prokurimit në DST, është dorëzuar vetëm një autodeklaratë ku citohet se “ **Të gjitha ambalazhet që do të përdoren për ambalazhim janë në përputhje dhe conform VKM nr 798, datë 29.09.2010 dhe Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve si dhe Ambalazhet që do të përdoren për këtë procedurë prokurimi janë një përdorimsh dhe si të tillë nuk kanë nevojë për pajisje larëse” e firmosur më datë 18.01.2021 nga administrator Ervin KRISTO. Ndërkohë për mostrat e dorëzuara të pikës 7 të kapacitetit teknik pika 2. ““*Kontenitor plastike të ripërdorshëm me qese plastmasi njëpërdorimëshe, për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, në 3 (tre) përmasa që fillojnë nga 30 L deri në 60 L, shoqëruar me mekanizëm hapje me pedale për cdo përmasë, sipas Udhëzuesit Kombëtar te Administrimit te Sigurte te Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.” Operatori ka dorëzuar kontenitor plastik të ripërdorshëm, për të cilat duhet të ngarkonte në SPE dokumentacionin përkatës në përputhje me pikën 8 të Kapacitetit Teknik, pasi ai nuk garanton larjen dhe dezinfektimin e këtyre lloj kontentorësh , ndërkohë deklaroi se përdor vetëm kontentinor njëpërdorimsh, gjë e cila bie në kundërshtim me mostrat e dorëzuara.****

6. **Oferta e vlerësuar anomalisht e ulet nga KVO ne baze te nenit 66 te VKM nr 914 i ndryshuar, KVO ka kerkuar operatorit sqarim oferte ekonomike me nr. 198 prot date 19.01.2021,te ngarkuar ne SPE te ciles nuk ju kthye asnje pergjigje justifikuese brenda afatit te parashikuar ne LPP.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*Eco Riciklim, Rr.3 Deshmoret Yzberisht, Tirane*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 21 112 638 (njëzetë e një milion e njëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH /pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Spitalit Rajonal Vlorë, Lagjja "Partizani"* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 22.01.2021

Ankesa: Nuk ka pasur ankesa

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Brunilda Mersini